



Pranuar / Dorëzuar Prilapen / Predato Received / Delivery	22-02	2021	1	viti god year
Organ / Institucia Org / Inst	Nr. Prot. in Prot. Prot. No.	Shtesa Protog. Appendix	Sasia Koliciteti Quantity	
SKRIMSHK	761/2021		113	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.33/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti - kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Eshref Shabani, anëtar, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses për shqyrtimin e ankesës A.nr.33/2021 të datës 27.01.2021 kanë shqyrtuar ankesën e parashtruar nga ankuesi me adresë: Rruga "Shabe Bajrami", Nr.19, nga komuna e Kaçanikut, kundër organit të punësimit Komuna e Kaçanikut, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 22.02.2021 mori këtë;

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Shpallet **jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A.nr. 33/2021 të datës 27.01.2021 të parashtruar nga ankuesi

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi ka aplikuar në konkursin e datës 10.11.2020 të shpallur nga Komuna e Kaçanikut, në pozitë "Mësimdhënës për lëndë Ekonomike", në Shkollën e Mesme Profesionale "Feriz Guri" dhe Vëllezërit Caka". Me datë 13.01.2021 përmes adresës elektronike ankuesi është njoftuar për për zgjedhjen e kandidatit të suksesshëm. I pa kënaqur me njoftimin e datës 13.01.2021, për mos për zgjedhjen e tij në këtë pozitë, ka parashtruar ankesë në Komisionin për zgjedhjen e kontesteve dhe të ankesave në Komunën e Kaçanikut, i cili me datë 13.01.2021 ka nxjerrë Vendimin me numër 04nr.111/01-28597/2020, me të cilin i ka refuzuar ankesën ankuesit, si të pa bazuar.

Ankuesi kundër Vendimit me numër 04nr.111/01-28597/2020 të datës 13.01.2021, ka parashtruar ankesë me datë 27.01.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 27.01.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokolli 324/2021; Njoftimin e datës 21.01.2021 me numër 04Nr.111/01-28597/2020; Listën e datës 30.12.2020 për kandidatët që kanë plotësuar kushtet e konkursit; Kopja e konkursit të shpallur me datë

Handwritten signature

10.11.2020 me numër 04Nr.111/01-28597/2020; Përgjigje në ankesë e datës 18.01.2021; Pliko e datës 25.01.2021 numër R 9802849; Përgjigje ne ankesë e datës 11.02.2021; Konkursi i datës 10.11.2020; Vendimi i datës 10.12.2020; Regjistrimi i aplikacioneve të pranuar të datës 24.12.2020; Përcaktimi i kritereve për testimin me shkrim dhe me gojë; Lista e testit me shkrim i datës 06.01.2021; Vlerësimi individual i kandidatëve; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Raporti Final i Rekomandimit nga Komisioni Përzgjedhës i datës 20.01.2021; Lista e datës 30.12.2020, e kandidatëve të cilët i kanë plotësuar kushtet; Lista e kandidateve që kanë kaluar testin me shkrim, e datës 12.01.2021; Njoftimi i datës 21.01.2021; Ankesa e datës 14.01.2021; Përgjigje në ankesë e datës 18.01.2021; Formulari për aplikim për mësimdhënës, i datës 11.12.2020; Diplomë e datës 11.12.2018; Aplikacion për punësim; Diplomë e datës 21.06.2010; certifikata; certifikatë e datës 27.05.2009; certifikatë; Vendim i datës 28.02.2011; Fletë rekomandim i datës 27.11.2011; certifikata; testi me shkrim; Formulari për aplikim për mësimdhënës, i datës 18.12.2020; Diplomë i datës 24.04.2019; Diplomë e datës 18.07.2011; Referencë e datës 01.09.2015; certifikatë e datës 23.11.2018; certifikata; vërtetim i datës 04.12.2006; certifikatë; pasqyra e llogaris së trustit; Testi me shkrim i datës 06.01.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të dërguara nga palët, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi .

**SEPSE**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke iu referuar provave të lëndës, konstaton se ankuesi ka aplikuar, në pozitë "Mësimdhënës për lëndë Ekonomike", në Shkollën e Mesme Profesionale "Feriz Guri" dhe Vëllezërit Caka", në konkursin e datës 10.11.2020 të shpallur nga Komuna e Kaçanikut dhe se pozita në të cilën ka aplikuar nuk i përket pozitës së shërbyesit civil por nëpunësit të shërbimit publik konformë ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik respektivisht nenit 2 paragrafi 4 i këtij ligji.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se nuk është kompetent për shqyrtimin e kësaj çështje dhe e drejta e ankuesit për tu ankuar, është e përcaktuar në nenin 24 paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, ku përcakton se: "*Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente*". Në rastin konkret ankuesi pas pranimit të vendimit të datës 13.01.2021 të Komisionit për zgjedhjen e kontesteve dhe të ankesave të Komunës të Kaçanikut, ka të drejtë të fillojë procedurën për inicim të kontestit Administrativ në Gjykatën kompetente, sepse procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-212 të Punës, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr.03/L-068 për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës dhe Udhëzimit Nr.15/2019 Administrativ të MASHT-it.

Poashtu mbi bazë të deklaramentit të mësipërm kolegji konstaton edhe argumentin tjetër ligjor mbi të cilin konstatohet jokompetenca si në pikën 1 të dispozitivit edhe për faktin se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 74 paragrafi 5 për këtë kategori të shërbyesve publik përcakton shprehimisht se: "**Ankuesi, nëse nuk është i kënaqur me vendimin e organit të ankimit apo në rast se nuk merr përgjigje brenda afatit të përcaktuar në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, në afatin vijues prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente.**", dhe se pozita "Mësimdhënës për lëndë Ekonomike", në të cilën ka aplikuar ankuesi i përket pozicionit të nëpunësit të shërbimit publik andaj sipas legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për këtë kategori, sepse marrëdhënia e punës rregullohet me ligjin e punës.

Bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për praninë në Shërbimin civil, siç është përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafit 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.




Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet së: *Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente*”.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda A.nr. 33/2021, datë 22/02/2021**

  
**Zyle Millaku-Gojnovci**  
**Procesmbajtëse**



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kaçanikut
- Udhëheqësit të Personelit në Komunë të Kaçanikut,
- Arkivit të KPMSHCK-së

